



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës ,Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr-464-40384 të datës 29.09.2014, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 si dhe Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15Nr.464-11851 të datës 04.03.2016, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, shpallë

**NJOFTIM
PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK**

Komuna e Lipjanit, në pajtim me Vendimin paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr-464-40384 të datës 29.09.2014, Vendimin paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 si dhe Vendimin paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonën Kadastrale Lipjan 15Nr.464-11851 të datës 04.03.2016, do të jep në shfrytëzim në afat prej 10 viteve 6 lokale të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit :

Nr .	Numri i ngastrës	Adresa	Kati	Nr.i lokalit	Sipërfaqja	Vërejtje
1.	1920-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-përëndimore (ndërtesa te ish-Bestini)	I	1	39m ²	
2.	1920-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-lindore (ndërtesa te ish-Bestini)	I	2	43 m ²	

3.	1920-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-lindore (ndërtesa te ish-Bestini)	I	3	25 m ²	
4.	1920-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-lindore (ndërtesa te ish-Bestini)	I	4	50 m ²	
5.	1920-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-lindore (ndërtesa te ish-Bestini)	I	5	42 m ²	
6.	0-71409044- 0192600-29- 3-8-0	rr.Lidhja e Prizrenit-Lipjan, pjesa veri-lindore, në kuadër të ndërtesës me koncesion "Dino"	I	9	35 m ²	

Njoftohen personat fizik dhe juridik, të cilët dëshirojnë të konkurrojnë me ofertat e tyre për marrje në shfrytëzim të lokaleve të cekura, se ankandi publik për vlerësimin e ofertave do të mbahet në ndërtesën e Komunës në Sallën e Kuvendit Komunal me datë 05.05.2016 duke filluar në ora 10:00.

Çmimi fillestar për periodën 10 vjeqare të shfrytëzimit të lokalave përcaktohet për sipërfaqen për çdo m² të lokalit në shumë prej 4 Euro për m².

Pagesa e çmimit nga ofertuesi fitues në ankand do të bëhet në pajtim me Kontratën për dhënie në shfrytëzim për periodën 10 vjeqare të lokalit në dhjetë kiste të barabarta me obligim të pagesës sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Lokalet do të ipen në shfrytëzim në gjendjen ashtu siq janë në ditën e shpalljes së këtij ankandi, kështu që pas lidhjes së kontratës, kërkesat për riparim të lokaleve dhe stabilimenteve nuk do jenë obligim dhe nuk do të miratohen nga Komuna për zbritjen e çmimit të kontraktuar.

Aplikuesit mund të konkurojnë për marrjen në shfrytëzim të lokaleve të cekura për një apo më tepër lokale sipas parimit një ofertë një lokal.

Konkurimi për pjesëmarrje në Ankand bëhet duke dorëzuar aplikacionin me ofertë në kover të mbyllur.

Oferta duhet të përmbajë : shënimet e ofertuesit, numrin e këtij njoftimi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi lokalin për të cilin konkurohet në ankand, çmimin ofertues të shënuar me numër dhe shkronja, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulloset nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kovertë të mbyllur.
Koverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të
Komunës së Lipjanit
Pjesëmarrje në Ankand Publik**

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3 në formë elektronike nga Webfaqja e Komunës .

Aplikacioni bashkë me ofertën në kovertë të mbyllur dorëzohet brenda afatit prej 30 dite nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi deri në ora 16:00 në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 3 .

Ofertat të paprecizuara, të panënshkrura dhe të ofertuara me çmim më të ultë se çmimi fillestar i publikuar me këtë Njoftim nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave në ankand publik marin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Komisioni në ankand i bën publike çmimet e ofertuara të secilës ofertë për lokalit përkatës.

Konform nenit 6 par. 2 të Rregullores së cekur, përmes ankandit publik Komisioni bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më lartë të ofruar në ankand publik.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do ti dërgohet fituesit, do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës .

Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë të informohen lidhur me procedurat e këtij ankandi, të shohin lokalet që do të jenë objekt i dhënies në shfrytëzim dhe të kenë qasje në dokumentacionin e pronës.

Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë të tërhiqen nga pjesëmarrja në ankand së paku tri ditë para mbajtjes së ankandit.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i dytë - zyra nr 106 Sektori për çështje pronësore-juridike ose në tel 038-200-41-507.

Nr. 1-400-16824

Kryesuesi i Komisionit

Me datë: 06.04.2016

Avni Olluri

